REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1791/1 prot. Tiranë, më 20 . 10 . 2026

V E N D I M

Nr. 277 , datë 20 . 10 . 2026

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi[1], është paraqitur ankesa nr. 253 Regj., datë 30.09.2026, e shtetases V. T kundër njëmbëdhjetë gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë[2], me pretendim diskriminimin për shkak të *"çdo shkak tjetër[3]"*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, Av. V. T ka parashtruar se përgjatë ushtrimit të profesionit të saj pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është përballur me një seri veprimesh dhe mosveprimesh nga trupa e gjyqtarëve pranë kësaj gjykate.
Në mënyrë të përmbledhur, ankuesja pretendon se një sërë shkeljesh kundrejt saj nga ana e gjyqtarëve të kësaj Gjykate, duke evidentuar ndër të tjera se:

- Gjyqtarët kanë pushuar një çështje penale ku ajo ishte viktimë akuzuese pa kryer njoftimet proceduriale, në shkelje të Kodit të Procedurës Penale.
- Dosjet e saj janë mbajtur manualisht dhe është bllokuar hedhja e tyre në shortin elektronik (sistemin ICMIS) për disa muaj.

[1] Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.
[2] G. H, D. Xh, S. P, A. S, M. F, L. Ç, E. P, E. D, F. D, A. H dhe O. L.
[3] Bindjeve profesionale dhe ushtrimit të detyrës si avokate.

- Është përjashtuar nga listat e caktimit të avokatëve kryesisht ose është vlerësuar me tarifa minimale (3,000 lekë) pas muajit tetor 2023, kur mori në mbrojtje shtetasin S. B.
- Është kërcënuar verbalisht dhe bullizuar nga Kryetari i Gjykatës dhe gjyqtarja A. H brenda ambienteve të institucionit.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar, ndër të tjera, nga Komisioneri që të nisë një hetim administrativ ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë dhe të konstatojë diskriminimin, të vendosë sanksione me gjobë dhe të urdhërojë ndërprerjen e kësaj sjelljeje.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: "'*Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të

shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Pas shqyrtimit paraprak të elementeve të formës dhe përmbajtjes së ankesës, si dhe natyrës së shkeljeve të pretenduara, Komisioneri vlerëson se kjo ankesë nuk hyn në fushën e kompetencave lëndore të këtij institucioni, për arsyet ligjore si më poshtë:

- *Lidhur me pretendimet për veprimet proceduriale gjyqësore dhe bllokimin e shortit (ICMIS) nga ana e njëmbëdhjetë gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (G. H, D. Xh, S. P, A. S, M. F, L. Ç, E. P, E. D, F. D, A. H dhe O. L)*

Komisioneri vëren se, veprimtaria e gjyqtarëve gjatë shqyrtimit të çështjeve (siç është vendimi për pushimin e çështjes pa njoftim) dhe administrimi i dosjeve gjyqësore (shorti elektronik) përbëjnë veprimtari të pastër me natyrë juridiksionale dhe proceduriale gjyqësore. Bazuar në parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor, Komisioneri (si organ administrativ i pavarur) nuk ka autoritet ligjor të kontrollojë, hetojë apo rishikojë vendimmarrjet dhe procedurat e ndjekura nga gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë në kuadër të dosjeve gjyqësore.

- *Lidhur me pretendimin e caktimit të avokatëve kryesisht dhe etikën e gjyqtarëve*

Komisioneri vëren se, pretendimet e ankueses lidhur me parregullsitë në listat e avokatëve kryesisht, anashkalimin e saj në kundërshtim me listat zyrtare të dhomës së avokatisë, si dhe sjelljet që prekin etikën profesionale të gjyqtarëve (kërcënimet e pretenduara dhe bullizimi), përbëjnë shkelje të mundshme disiplinore dhe etike të funksionarëve të drejtësisë. Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i vetmi organ kompetent për të hetuar shkeljet disiplinore, etike dhe administrative të gjyqtarëve është Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), ndërsa organet e qeverisjes së sistemit si Këshilli Lartë Gjyqësor (KLGJ) janë përgjegjëse për menaxhimin e veprimtarisë gjyqësore. Vetë ankuesja ka konfirmuar në ankesë se ka nisur kërkesë pranë KLGJ-së për këto çështje.

Sa më sipër, nenet 21 dhe 32, të ligjit nr. 10221 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktojnë shprehimisht kompetencat e Komisionerit lidhur me shqyrtimin e ankesave ndaj personave fizikë ose juridikë. Ligji nuk i jep asnjë kompetencë KMD-së për të ushtruar mbikëqyrje, hetim apo të vendosë sanksione ndaj gjyqtarëve në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tyre në pushtetin gjyqësor. Rrjedhimisht, meqenëse shkeljet dhe veprimet e pretenduara lidhen me veprimtarinë proceduriale gjyqësore dhe etikën e magjistratëve, zgjidhja e këtij konflikti

mbetet jashtë juridiksionit dhe kompetencave lëndore të KMD-së, e për pasojë ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj[4].

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktohet se:*"4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji..."*.

- *Komisioneri evidenton gjithashtu, mungesën e një shkaku të mbrojtur nga LMD-ja, sipas argumentit të mëposhtëm*

Nga përmbajtja e ankesës rezulton se subjekti ankues nuk ka individualizuar dhe konkretizuar një shkak diskriminues të mbrojtur nga neni 1 i ligjit nr. 10221/2010, i cili të ketë shërbyer si bazë për trajtimin e pretenduar të pafavorshëm.

Në kuptim të nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010, diskriminimi nuk konsiston në çdo trajtim të padrejtë, çdo shkelje ligjore apo çdo konflikt të krijuar ndërmjet një individi dhe një autoriteti publik. Për të qenë i tillë, dallimi, përjashtimi, kufizimi ose preferenca duhet të jetë i bazuar në një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit dhe të ketë si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit të një të drejte ose lirie në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

Në rastin konkret, ankuesja i referohet në mënyrë të përgjithshme "çdo shkaku tjetër", pa identifikuar një karakteristikë, status ose rrethanë personale të mbrojtur nga ligji. Pretendimi se trajtimi i pafavorshëm ka ardhur për shkak të bindjes së saj profesionale ose mënyrës së ushtrimit të profesionit të avokatit nuk përbën, në vetvete, një shkak diskriminues të mbrojtur nga LMD-ja.

Fakti që ankuesja ka pasur mosmarrëveshje me gjyqtarë, pretendon se nuk është përfshirë në listat e avokatëve kryesisht, është paguar me tarifa të caktuara apo ka pasur konflikte lidhur me ushtrimin e profesionit, nuk mjafton, në vetvete, për të krijuar një pretendim prima facie për diskriminim, në mungesë të identifikimit dhe provimit të një shkaku të mbrojtur dhe të lidhjes së tij me trajtimin e pretenduar të pafavorshëm. Për rrjedhojë, mungon një prej elementeve themelore të pretendimit për diskriminim: *shkaku* dhe *lidhja e tij me trajtimin e pretenduar të pafavorshëm*.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, i cili citon se: *"Ankesa nuk pranohet nëse .....nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim"*, ankesa nuk mund të pranohet dhe

[4] Për analogji shih vendimet: nr. 70, datë 12.06.2019, nr. 02, datë 11.01.2021, nr. 37, datë 10.02.2022, të KMD-së.

për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj[5].

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronjat b) dhe ç), të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankueses për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, pika 4/b/ç, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar,
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, V. T, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

[5] Shih Vendimet: nr. 127, datë 28.05.2026, dhe nr. 143, datë 28.05.2026, nr. 170, datë 16.06.2026, të KMD-së.